



Datë: 7 Shkurt 2024

TERMA REFERENCE

EKSPERT PËR REALIZIMIN E SESIONEVE TË INFORMIMIT MBI PRINDËRIMIN POZITIV

1. HYRJE

Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri (QDGJSH) është një organizatë jofitimprurëse, e pavarur, jo-politike, e cila punon për fuqizimin e grave dhe vajzave, mbrojtjen e drejtat e tyre dhe lufton pabarazitë gjinore. QDGJSH është regjistruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë më datë 28/06/2022 me vendimin nr. 1738. Sipas legjislacionit në fuqi, QDGJSH është regjistruar gjithashtu pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, Tiranë me nr. NIPT: M22002451K.

Misioni i Qendrës është të kontribuojë për krijimin e një shoqërie ku të gjitha gratë të jetojnë një jetë me dinjitet, pa diskriminim dhe me mundësi të barabarta.

Qasja e Qendrës për Drejtësi Gjinore në Shqipëri, është:

- Të punojë për parandalimin e dhunës me bazë gjinore, rritjen e nivelit të informimit dhe ndërgjegjësimin të shoqërisë shqiptare rreth të drejtave të grave dhe çështjeve gjinore;
- Të mbështesë gratë dhe vajzat për të rritur pjesëmarrjen dhe influencën e tyre në jetën sociale, ekonomike dhe politike të vendit nëpërmjet zbatimit të programeve të lidershit, rritjes së aftësive profesionale, etj.;
- Të adresojë nevojat e grave dhe vajzave viktime të dhunës me bazë gjinore, përfshirë dhunën në familje, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve direkte me qëllim fuqizimin e tyre social dhe ekonomik;
- Të rrisë kapacitetet e punonjësve të institucioneve shtetërore dhe jo-shtetërore që punojnë për mbrojtjen dhe ofrimin e shërbimeve për gra dhe vajza;
- Të advokojë dhe llojojë për respektimin e të drejtave të grave dhe arrijtjen e drejtësisë gjinore në shoqërinë shqiptare;
- Të kryejë studime, analiza dhe kërkime rreth çështjeve gjinore, përfshirë dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje.

2. INFORMACION MBI SHËRBIMIN E KËRKUAR

Qendra për Drejtësi Gjinore po zbaton projektin “Informim dhe mbështetje direkte për viktimat e dhunës në familje në Bashkinë Lushnjë” në kuadër të Programit Rajonal mbi Demokracinë



Financuar nga
Bashkimi Evropian



Programi Rajonal mbi Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor 2 – ReLOaD2 financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).



Vendore në Ballkanin Prendimor 2 (ReLOaD2), i cili financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), duke mbështetur bashkitë në zhvillimin e mekanizmave transparente të financimit për OSHC-të, në mënyrë që të përmirësojë ofrimin e shërbimeve për qytetarët në komunitetin lokal. Në kuadër të zbatimit të këtij projekti, **organizata kërkon të kontraktojë një ekspert për realizimin e 6 sesioneve të informimit rreth prindërimit pozitiv (6 ditë pune) me anëtarë të komunitetit në Bashkinë Lushnjë (përfshirë gra, viktima të dhunës në familje)**. Shërbimi do të ofrohet gjatë periudhës 1 Mars – 31 Gusht 2024.

3. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË KRYESORE

- Të hartojë modulet e sesioneve të informimit dhe t'i dorëzojë ato tek Koordinatori i Projektit të paktën 5 ditë para realizimit të çdo sesi informues;
- Të realizojë 6 sesione informimi me 120 anëtarë të komunitetit (rreth 90 gra dhe 30 burra) në Bashkinë Lushnjë;
- Të bashkëpunojë me Koordinatorin e Projektit dhe Drejtorinë e Shërbimeve Sociale të Bashkisë Lushnjë, specifikisht me Njësinë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të Rasteve sa i përket organizimit të sesioneve të informimit;
- Të hartojë Planin e Punës në bashkëpunim me Koordinatorin e Projektit;
- Të respektojë afatet e vendosura në Planin e Punës;
- Të hartojë dhe dorëzojë në kohë raportin mbi punën e kryer sipas afateve të vendosura nga Koordinatorin e Projektit;
- Të mbajë kontakte dhe bashkëpunim korrekt me stafin/konsulentët e tjerë të përfshirë në projekt;
- Të respektojë me rigorozitet rregullat e konfidencialitetit të organizatës.

4. KUALIFIKIME DHE AFTËSI TË KERKUARA

- Diplomë universitare në degën psikologji ose punë sociale;
- Të këtë eksperiencë të mëparshme pune me grupet vulnerabël (preferohen eksperiencat në bashkëpunim me organizata të shoqërisë civile);
- Të jetë i/e motivuar dhe fleksibël me ngarkesën e punës;
- Të jetë sistematik/e në punë;
- Të zotërojë aftësi shumë të mira komunikuese;
- Të jetë bashkëpunues/e, me qasje pozitive dhe etikë profesionale.

5. PROCESI I APLIKIMIT

Aplikantët e interesuar duhet të dërgojnë me shkrim në adresën elektronike ose adresën postare të Qendrës për Drejtësi Gjinore dokumentacionin e poshtëshënuar:



Financuar nga
Bashkimi Evropian



Programi Rajonal mbi Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor 2 – ReLOaD2 financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).



- Curriculum Vitae (përfshirë referenca të punëdhënësve të mëparshëm);
- Dokumenta që vërtetojnë edukimin (kopje e diplomës universitare, master, etj.);
- Ofertë financiare për shërbimin e kërkuar (kosto për ditë pune).

Adresë elektronike: genderjusticealbania@gmail.com; adena.vangjeli@gjalbania.org

Adresë postare: Rr. "Nikolla Tupe", P. 352, Ap. 3, Tiranë, Shqipëri.

6. AFATET

Afati për dërgimin e aplikimeve: 15/02/2024, ora 17:00



Financuar nga
Bashkimi Evropian



Programi Rajonal mbi Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor 2 – ReLOaD2 financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).